



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:054076

Datë: 09.08.2019

Numri i dokumentit: 00452907

P.nr.924/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës L.P., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga 374/1 te KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr. 1332/2018 të datës 26.12.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **08.08.2019**, në prani të Prokurorit te shtetit Deshire Jusaj dhe të akuzuarës L.P., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **L.P.**, K.Gjakovë, e bija e D. dhe e nënës H. e gjinisë K., data e lindjes..., ,ka te kryer 7 kl. të shkollës fillore, e gjendjes se dobët ekonomike, e pa punë, e martuar nënë e tre fëmijëve, shqiptare, shtetas i R. Kosovës, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r e :

Sepse:

- **nga data e pa vërtetuar deri me datë 06.08.2018, në ora 21:00**, në shtëpinë e saj, Komuna Gjakovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën. par .1.1 të Ligjit mbi armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që pasi kishte një aheng familjar policia kishte informacion se janë dëgjuar të shtëna dhe gjatë bastisjes dhe kontrollit nga ana zyrtarëve policor, e pandehura ka pranuar se posedon armën e tipit “Ekol Special 99 “ me nr.serik ..., me një karikator të zbrazët, të cilën vullnetarisht ia dorëzon zyrtarëve policor dhe e njëjta është sekuestruar.

-me çka ka kryer vepër penale mbajtja ne pronësi ,kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par. 1 te KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,43,46,73,74 dhe nenit 374/1 të KPRK-ës, dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarës L.P. , i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej 600,00-€ (gjashtëqind euro), të cilin dënim është e detyruar ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi .

Detyrohet e akuzuaria që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 30,00.-€, në afat prej 15 ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-ës ,

Konfiskohet arma e tipit “Ekol Special 99 “ me nr. serik, me një karikator të zbrazët, si objekt i kryerjes së veprës penale e sekuestruar me dt.06.08.2019 .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1332/2018 të datës 26.12.2018 e ka akuzuar të akuzuarën P., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolli ose posedimi të paautorizuar të armëve nga 374/1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Deshira Jusaj, gjatë shqyrtimit fillestar me dt.08.08.2019, pas leximit të aktakuzës dhe pasi i akuzuara ka pranuar fajësinë ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, por bene përmirësimin e emrit të akuzuarit si në procesverbal .

E akuzuara L.P., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se armen në fjalë e kam blere nga një persona nga Shqipëria një vitë me herët duke mos e ditur se e njëjta është e ndaluar vetëm për çështje sigurie me qene se jetojë në fshatë në një shtëpi e cila është larg nga shtëpitë tjera pasi një vite më herët me është thyer shtëpia me qëllim vjedhje. Me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet edhe pse të njëjtën asnjëherë më pare nuk e kam keqpërdorur ,po ashtu është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin .I propozoi gjykatës që duke marr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë për veprën e kryer, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe do të jem me i kujdesshëm si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me të butë.

Në shqyrtimin fillestar gjykatë ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se e akuzuara L.P.: **se nga data e pa vërtetuar deri me datë 06.08.2018, në ora 21:00**, në shtëpinë e saj në fshatin C., Komuna Gjakovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën. par .1.1 të Ligjit mbi armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që pasi kishte një aheng familjar policia kishte informacion se janë dëgjuar të shtëna dhe gjatë bastisjes dhe kontrollit nga ana zyrtarëve policor, e pandehura ka pranuar se posedon armën e tipit “Ekol Special 99 “ me nr. serik, me një karikator të zbrazët, të cilin vullnetarisht ia dorëzon zyrtarëve policor dhe e njëjta është sekuestruar.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës se është nënë e 3 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, pendimin e saj, sjelljen korrekte në gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet si dhe faktin se e njëjta me pare nuk ka qene e dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata te akuzuarës L.P. ,i shqiptojë dënimin me gjobë në shumën prej 600,00 -€(gjashtëqind euro), me bindjen e plote se ky dënim është ne harmoni me peshën e veprës penale ,shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarës dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarës do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës . Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit, se kjo do të ndikoj tek e akuzuara që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin armës së tipit “Ekol Special 99 “ me nr.serik, me një karikator të zbrazët, është marr bazuar ne nenin 374/3 te KPRK-ës .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.924/18 datë 08.08.2019.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **1 ditësh** , nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykatë.